



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.476/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Milena Đerić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli ne Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohen** të pabazuara ankesat Anr. 476/2021, Anr. 478/2021, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli ne Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli ne Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr. 476/202 dhe Anr. 478/21 dhe të datës 14.02.2021, të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli ne Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit Lëvizja Vetëvendosje, me seli ne Prishtinë, me të cilat kanë pretenduar se me datë 13.02.2021 dhe 14.02.2021, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, asamblisti i LVV në komunën e Fushë Kosovës Durim Hajra, kandidati i LVV Eman Rrahmani dhe asambleisti i LVV në komunën e Prishtinës Egzon Azemi, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen të bazuara.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, për ankesat që janë bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë.

Në përgjigje në ankesat A.nr.476/202 dhe Anr. 478/21 të datës 14.02.2021, Lëvizja Vetëvendosje i ka kundërshtuar ankesat si të pasafatshme dhe të pabazuara për arsye se sipas tyre ankesat për thyerje të heshtjes duhet të paraqiten para mbylljes së qendrave të votimit, që i bie para orës 19:00 ndërsa ankesat e PDK-së janë paraqitur pasi janë mbyllur qendrat e votimit dhe pasi ka kaluar heshtja zgjedhore, e me të cilin veprim ankuesi ka shkelur nenin 21.3 lidhur me nenin 25.1 të Rregullës Zgjedhore 09/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i

përgjigjes në ankesë LVV i ka propozuar PZAP-së që ankesat ti hudh poshtë si të pasafatshme ose ti refuzojë si të pabazuara.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të pabazuara**

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr. 476/202 dhe Anr. 478/21 të datës 14.02.2021, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur nga e njëjta palë ankuese kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 13.02.2021 dhe 14.02.2021.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia Anr. 476/2021 më datën 16.02.2021**

**Kryesuese e Panelit**  
Afijete Sada Glllogjani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa ne kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.

